



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS  
ADMINISTRATORI

Nr. 2245 Prot

Durrës më 18 . 11 .2024

## NJOFTIM

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 5 datë 14.11.2024 me Nr 2195 Prot., datë 14.11.2024 të Rektoratit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Vendimin Nr.60 datë 15.11.2024, me Nr.2224/8Prot., datë 15.11.2024 të Bordit të Administrimit, ju bëjme me dije se Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës është i interesuar për dhënien me qera të një ambienti me sipërfaqe 198m<sup>2</sup> të ndodhur brenda Godinës Nr. 1 të kampusit universitar nën administrimin e tij, me adresë Lagjia Nr. 17, Spitalllë me objekt përdorimi për “Ofrimi i Shërbimit të Ushqimit”, për një afat 12 muaj.

Personat e interesuar duhet të depozitojnë pranë Zyrës së Protokoll-Arshivës së Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, me adresë Lagjia Nr.1, Rruga Taulantia, Currila, Durrës, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij njoftimi, dokumentacionin origjinal ose të njëjësuar me origjinalin, bazuar në pikën 7 të Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Planbизнесin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përshkruhen qartë: plani i punësimit, plani i investimeve, si dhe treguesit që do të realizohen;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë;
- Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

**\*Shënim:** Në përcaktimin e ofertës subjektet e interesuar duhen të mbajnë parasysh tabelën “A” “Tarifat dysHEME të qirasë mujore për ndërtesat sipas qarqeve” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

ADMINISTRATOR

GERALD ÇEKA

